



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 11656
Datë: 23 / 5 / 2024

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në mbledhjen e mbajtur me datë 23.5.2024, mori vendim që të shpall:

THIRRJE

për mbështetje financiare të studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", të cilët i përkasin kategorisë së personave me aftësi të kufizuara

I

Kushtet e përgjithshme

1. Mbështetja financiare do të jepet për studentët me aftësi të kufizuara, në lartësi deri në 450.00 euro, varësisht numrit të përfituesve dhe buxhetit të miratuar nga Këshilli Drejtues.
2. Të drejtë aplikimi për mbështetje financiare kanë studentët të cilët i plotësojnë këto kushte:
 - 2.1 Të jenë studentë të rregullt të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";
 - 2.2 T'i kenë të regjistruar të dy semestrat e vitit akademik 2022/23;
 - 2.3 T'i përkasin kategorisë së personave me aftësi të kufizuar, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi.

II

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika një (I) e këtij konkursi, aplikimin duhet ta bëjnë përmes platformës elektronike SEMS në linkun: studenti.uni-pr.edu.
2. Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:
 - 2.1 Kërkesën për aplikim (fletë aplikacioni) i cili shkarkohet pas aplikimit përmes SEMS,
 - 2.2 Vërtetimin për statusin e studentit dhe dëshminë për regjistrim të vitit akademik 2023/24,
 - 2.3 Dokumenti (certifikata) i lëshuar nga institucioni i autorizuar, me të cilin vërtetohet statusi i subjektit si person me aftësi të kufizuara.
3. Studenti obligohet që fletë aplikacionin ta printoj dhe ta dorëzoj në shërbimin e studentëve të fakultetit përkatës, si dëshmi që ka aplikuar brenda afatit të paraparë të thirrjes.
4. Fakultetet janë të obliguara që në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë thirrje t'i përgatisin listat e studentëve të cilët i plotësojnë kriteret për përfitim të mbështetjes financiare, për miratim nga Këshilli Drejtues i UP-së.
5. Përgjegjësinë për saktësinë e të dhënave do ta bartin dekanët e njësive akademike.

6. Mbështetja financiare për vitin akademik 2023/24, ndahet për studentët e të gjitha niveleve dhe programeve të studimit, të cilët i përkasin kategorisë së personave me aftësi të kufizuara.
7. Nëse gjatë aplikimit paraqiten probleme eventuale teknike, të kontaktohet zyrtari i TI-së i fakultetit përkatës.

III

Afati i aplikimit

1. Aplikimi në linkun studenti.uni-pr.edu hapet prej datës 24.5.2024 deri me datë 7.6.2024, në orën 16:00.
2. Ditën e parë të konkursit, me datë 24.5.2024, aplikimi elektronik do të funksionalizohet nga ora 13:00.

IV

Afati i ankesave

1. Studentët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë për mbështetje financiare dhe nuk janë përfshirë në listën e studentëve përfitues të mbështetjes financiare, kanë të drejtë ankese në afat prej 48 orësh pas ditës së publikimit të listave.
2. Ankesat dorëzohen në zyrën e arkivit të UP-së (nr. 18), në ndërtesën e Rektoratit të UP-së.
3. Ankesat pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

V

Publikimi

Vendimi do të publikohet në tabelat e shpalljeve të fakulteteve si dhe në ueb-faqen e Universitetit: www.uni-pr.edu.



Këshilli Drejtues i UP-së

Altin Sahiti - kryesues